



Qendra për Arsim e Kosovës
Kosova Education Center

KEC

DUKAGJIN PUPOVCI
JEHONA SHALA
AFRORE LILA

AVANCIMI I KOMUNIKIMIT ME PRINDËR NË SHKOLLAT E KOSOVËS

Prishtinë, dhjetor 2009

Avancimi i komunikimit me prindër në shkollat e Kosovës

Kontakti:

Jehona Shala
Qendra për Arsim e Kosovës (KEC)
Kompleksi i Shkollës "Mileniumi i Tretë"
rr "Isa Kastrati", p. n.
Prishtinë
Tel/Fax. +381-38-244 257, lok. 106
E-mail: jxhaferi@kec-ks.org

Ky punim është realizuar në kuadër të projektit
"Avancimi i përfshirjes dhe cilësisë së arsimit në
Evropën Juglindore" me përkrahjen financiare të
Institutit për Shoqëri të Hapur – Budapest.

Të gjitha qëndrimet e shprehura në të janë të
autorëve dhe në asnjë mënyrë nuk duhet t'i
atribuohen Institutit.

Për autorët

Dukagjin Pupovci është drejtor ekzekutiv i Qendrës për Arsim të Kosovës (KEC) dhe hulumtues shumëvjeçar në fushën e arsimit. Është doktor i shkencave të matematikës, mësimdhënës universitar dhe pjesëmarrës aktiv në procesin e reformave të arsimit në Kosovë në të gjitha nivelet.

Jehona Shala ka mbaruar studimet universitare të Gjuhës angleze në Universitetin e Prishtinës. Në dhjetë vjetët e fundit është bashkëpunëtorë profesionale e Programit “Hap pas Hapi” që ofron metodologji për punë me fëmijë të moshës deri në 10 vjeç. Puna me prindër është një ndër shtyllat kryesore të këtij Programi. Po ashtu, është angazhuar si trajnere në programe të tjera që i kushtohet metodologjisë së punës në shkollë.

Afrore Lila është drejtoreshë e shkollës “Mileniumi i Tretë” e cila zbaton metodologji të avancuara të komunikimit me prindër. Ka mbaruar studimet universitare për Gjuhë dhe letërsi shqipe dhe është trajnere në disa programe për mësimdhënës dhe administratorë që menaxhohen nga Qendra për Arsim e Kosovës.

Falënderim

Autorët e këtij punimi dëshirojnë të shprehin mirënjohje të veçantë për:

- Zonjën Snježana Mrše nga organizata joqeveritare “Most” për ndihmë në hartimin e këtij projekti
- Z. Igor Repac nga Universiteti i Lubjanës për angazhim të vazhdueshëm në organizimin e aktiviteteve hulumtuese dhe koordinimin e komunikimit.
- Znj. Gordana Miljević nga Instituti për Shoqëri të Hapur në Budapest për iniciimin e këtij projekti.
- Drejtorët personelin dhe prindërit e shkollave pjesëmarrëse në këtë projekt për angazhim konstruktiv në realizimin e tij.

Përmbajtja

Executive Summary	6
Përmbledhja ekzekutive	7
1. Hyrje	8
2. Projekti hulumtues “Avancimi i komunikimit me prindër në shkollat e Kosovës”	9
2.1. Shkollat pjesëmarrëse në projekt	9
2.2. Metodologjia dhe procedurat e komunikimit me prindër	9
2.3. Informimi rreth përdorimit të metodologjisë	10
2.4. Monitorimi i shfrytëzimit të metodologjisë	10
2.5. Mbledhja e të dhënave	10
3. Çështjet kryesore të sondazhit	10
3.1. Përcaktimi i mostrës.....	10
3.2. Realizimi i sondazhit.....	11
4. Rezultatet dhe analiza e tyre	11
4.1. Të dhëna demografike.....	11
4.2. Variablat kyçe	12
5. Përfundimi.....	15
Shtojca 1: Metodologjia e komunikimit me prindër	16
Shtojca 2: Protokoli i intervistimit për drejtorë	25
Shtojca 3: Pyetësi për mësuesit	28

Lista e tabelave

Tabela 1. Numri i të intervistuarve sipas shkollave.....	10
Tabela 2. Personeli i anketuar sipas kualifikimit.....	11
Tabela 3. Personeli i anketuar sipas grupmoshës	12
Tabela 4. Perceptimi i ndikimit të prindërve në shkollë.....	12
Tabela 5. Perceptimi i barrierave në komunikimin me prindër	13
Tabela 6. Përfitimet e perceptuara të angazhimit të prindërve	13
Tabela 7. Dinamika e komunikimit me prindër.....	14
Tabela 8. Zbatimi i metodologjisë për takime individuale me prindër.....	14

Executive Summary

This research was carried out as part of the Project “Advancing Communication with Parents in Kosovo Schools” which is part of a regional initiative supported by the Open Society Institute which takes place in eight countries of South-East Europe. The objective of this project is to advance communication with parents by implementing the following major steps: 1) Select 3 urban and 3 rural schools for participation in the action research; 2) Develop methodology and procedures for communication with parents; 3) Inform teachers on the use of the new methodology and procedures; 4) Monitor the use of the new methodology in targeted schools; 5) Collect information from school management, teachers and parents on perceived usefulness of the methodology; 6) Organize a dissemination event.

Initially, five primary and lower secondary schools were selected, and, in cooperation with them, a methodology for individual communication with parents was developed. In the sequel, training of teachers for use of methodology in all targeted schools was organized, and the implementation itself was monitored.

The aim of the survey targeting five schools was to understand effects of applying the methodology for communication with parents in improving teacher-parent and school-parent interaction. It should be noted that the methodology is about structured individual meetings and also the fact that only one round of such meetings was organized during the life time of the project. Therefore, we refer to perceptions of teachers and school principals on usefulness of the methodology, rather than to objective conclusions regarding its impact on improvement of communication with parents

The survey targeted 143 class teachers and five principals of schools involved. More than 85% of the respondents expressed their belief that the methodology was useful for teachers and parents, and the same was confirmed by school principals.

According to our information, this is the first effort to promote individual communication with parents in Kosovo schools by introducing a methodology developed in a participatory way. Given encouraging results of the survey it is hoped that Kosovo schools will regularly apply individual meetings with parents. The methodology can be easily adapted to needs in various school contexts.

Përmbledhja ekzekutive

Ky hulumtim është zhvilluar në kuadër të projektit “Avancimi i komunikimit me prindër në shkollat e Kosovës” që zhvillohet në kuadër të një nisme rajonale të përkrahur nga Instituti për Shoqëri të Hapur dhe zbatohet në tetë vende të Regjionit të Evropës Juglindore. Qëllimi i këtij Projekti është të avancohet kapaciteti për komunikim me prindër në shkollat e Kosovës, përmes këtyre veprimtarive: 1) Përzgjedhja e tri shkollave urbane dhe tri shkollave rurale për pjesëmarrje në projekt; 2) Zhvillimi i metodologjisë dhe procedurave të komunikimit me prindër; 3) Informimi i mësimitdhënësve rreth përdorimit të metodologjisë dhe procedurave të zhvilluara; 4) Monitorimi i përdorimit të metodologjisë në shkollat e synuara; 5) Mbledhja e informatave nga menaxhmenti i shkollës dhe mësimitdhënësit për dobinë e perceptuar të kësaj metodologjie.

Fillimisht janë përzgjedhur pesë shkolla fillore dhe të mesme të ulëta dhe, në bashkëpunim me to, është zhvilluar metodologjia për komunikimin individual me prindër. Në vijim, është organizuar trajnimi i mësimitdhënësve në të gjitha shkollat e përfshira në projekt për zbatimin e metodologjisë, si dhe është monitoruar vetë zbatimi i saj në shkolla.

Qëllimi kryesor i sondazhit të organizuar në pesë shkolla ishte të kuptohen efektet e zbatimit të metodologjisë së komunikimit me prindër në përmirësimin e komunikimit mësimitdhënës-prind dhe shkollë-prind. Duhet pasur parasysh se metodologjia përqendrohet kryesisht në takime individuale të strukturuar, si dhe faktin se gjatë realizimit të projektit është organizuar vetëm një raund i takimeve të tilla. Për këtë arsye, më shumë mund të bëhet fjalë për perceptimin e mësimitdhënësve dhe drejtorëve të shkollave për dobinë e metodologjisë sesa për përfundime objektive në raport me ndikimin e saj në përmirësimin e komunikimit me prindër.

Hulumtimi që ka përfshirë 143 mësimitdhënës me përgjegjësi për klasën – kujdestarë klase dhe mësues klasorë, si dhe pesë drejtorët e shkollave të përfshira, ka treguar se mbi 85% e të anketuarve kanë shprehur bindjen se metodologjia për takim individual me prindër ishte e dobishme edhe për mësimitdhënësit edhe për prindërit. Konstatimin e njëjtë e kanë konfirmuar edhe drejtorët e shkollave të përfshira në projekt.

Sipas informatave me të cilat disponojmë, kjo është përpjekja e parë në shkollat e Kosovës që komunikimi me prindër të formalizohet dhe të zhvillohet sipas një metodologjie të përcaktuar paraprakisht. Duke marrë parasysh rezultatet inkurajuese të hulumtimit mbetet për të shpresuar se shkollat në Kosovë do të zbatojnë me rregull takimet individuale me prindër. Metodologjia e hartuar mund të përshtatet pa vështirësi të mëdha për kërkesa dhe kontekste të ndryshme.

1. Hyrje

Përkundër faktit se vendet e Evropës Juglindore janë në proces të reformave fundamentale të sistemit të arsimit akoma ka dallime të mëdha në mundësi për pjesëmarrje në arsim, si dhe në cilësinë e rezultateve të arsimit. Në këtë aspekt, Instituti për Shoqëri të Hapur (OSI) është përqendruar në çështjen e pjesëmarrjes së prindërve në jetën e shkollës që është një aspekt qenësor i funksionimit efektiv të shkollës.

Në funksion të adresimit të kësaj çështjeje ka filluar së zbatuari projekti i përbashkët “Avancimi i përfshirjes dhe cilësisë së arsimit në Evropën Juglindore”, në të cilin marrin pjesë institucione nga tetë vende të Rajonit: Bosnja dhe Hercegovina, Serbia, Mali i Zi, Kosova, Maqedonia, Shqipëria, Rumania dhe Moldavia. Përkundër dallimeve në kontekst, përmes një vargu të takimeve të ekspertëve është arritur të identifikohen problemet e përbashkëta për të gjitha vendet:

1. Tendenca për shtimin e pabarazisë në arsim.

Me gjithë se punohet në hartimin e politikave të reja për tejkalimin e dallimeve ekzistuese brenda sistemit të arsimit, ekziston një ngecje në jetësimin e tyre. Në shumë vende akoma mungojnë fonde për plotësimin e nevojave të grupeve të margjinalizuara, siç janë: sigurimi i asistentëve në klasat me prani të konsiderueshme të fëmijëve nga grupet tjera gjuhësore, refuzimi për t'i regjistruar në shkollë fëmijët me nevoja të veçanta, hapësira joadekuate për fëmijë me paaftësi fizike, etj. Përveç këtyre formave të hapura të diskriminimit, janë të pranishme edhe forma më pak të dallueshme si ndërlidhja e qartë e cilësisë së shërbimeve me statusin socio-ekonomik të fëmijëve dhe komuniteteve përkatëse.

2. Pjesëmarrja e pamjaftueshme dhe/ose joadekuate e prindërve dhe e palëve të tjera me interes në jetën e shkollës.

Edhe pse ekzistojnë instrumente për sigurimin e pjesëmarrjes së familjes dhe komunitetit në jetën e shkollës, në përgjithësi, kjo pjesëmarrje nuk mund të quhet e kënaqshme. Për më tepër, shpesh është vetëm formale dhe nuk ndikon në avancimin e punës në shkollë dhe në shtimin e mundësive për fëmijë.

3. Cilësia e ulët e qeverisjes dhe udhëheqjes në shkollë.

Kjo shihet si shkak dhe pasojë e pabarazive ekzistuese brenda sistemeve të arsimit. Pa dyshim se një dukuri e tillë lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë me përfshirjen në jetën e shkollës.

Projekti që zbatohet në tetë vendet e lartpërmendura ka dy qëllime: 1) të kuptohen më mirë shkaqet e dispariteteve ekzistuese në cilësinë e arsimit dhe mundësitë e barabarta, duke bërë sondazh të drejtorëve në nivel të vendeve pjesëmarrëse; 2) të përkrahen nismat lokale, kombëtare ose rajonale për përmirësimin e cilësisë dhe përfshirjes në jetën e shkollës. Të gjitha aktivitetet mbështeten në një kornizë të thjeshtë, por rigorozë, e cila është e njëjtë për të gjitha vendet pjesëmarrëse.

Fillimisht, është bërë një hulumtim në bazë të një sondazhi të drejtorëve të shkollave që hulumton masën në të cilën është e pranishme pjesëmarrja e prindërve (në vendimmarrje, në aktivitete jashtë mësimore, dhe në arsimimin e fëmijëve të tyre) në shkolla publike në raport me faktorët në nivel të shkollës, si dhe me qëndrimet e besimet e drejtorëve të shkollave¹. Në të janë përfshirë 41.5% të shkollave fillore të Kosovës ku mësojnë 44.6% të nxënësve dhe punojnë 42.2% të

¹ Pupovci, D. & Tafarshiku, N., 2008. Pjesëmarrja e prindërve në jetën e shkollës në Kosovë - Një rrugë drejt ndryshimit. Available at: http://www.see-educoop.net/aeiq/reports/kosovo_report.pdf.

mësimdhënësve. Prandaj, edhe mund të pretendohet se rezultatet e hulumtimit vlejné për tërë popullacionin e shkollave fillore në Kosovë.

Rreth 60% të drejtorëve të anketuar kanë shprehur rezervë ndaj cilësisë së takimeve me prindër që organizojné mësimdhënësit e shkollës, ndërsa mbi 75% janë shprehur se shkolla nuk ka strategji të komunikimit me prindër. Kjo flet për nevojën e përcaktimit të disa normave të komunikimit me prindër, si dhe për aftësimin e personelit që të vendosin një komunikim efektiv që është në funksion të përmirësimit të mësimdhënies dhe mësimnxënies.

Nga këto rezultate ka dalë edhe rekomandimi vijues:

“Shkollat duhet të zhvillojnë procedura për takime me prindër që përcaktojnë dinamikën, përgatitjen dhe rrjedhën e takimeve të tilla. Duhet të praktikohen si takime grupore/tematike, ashtu edhe takime individuale me prindër. Ndërkaq, mësimdhënësit duhet të aftësohen për menaxhimin e takimeve të tipave të ndryshëm dhe për vënien e tyre në funksion të avancimit të mësimdhënies dhe nxënies në shkollë.”

2. Projekti hulumtues “Avancimi i komunikimit me prindër në shkollat e Kosovës”

Qëllimi i këtij Projekti është avancimi i kapaciteteve për komunikim me prindër në shkollat e Kosovës. Ndërkaq, ideja e realizimit konsiston në këta hapa:

1. Përzgjedhja e tri shkollave urbane dhe tri shkollave rurale për pjesëmarrje në projekt,
2. Zhvillimi i metodologjisë dhe procedurave të komunikimit me prindër,
3. Informimi i mësimdhënësve rreth përdorimit të metodologjisë dhe procedurave të zhvilluara
4. Monitorimi i përdorimit të metodologjisë në shkollat e synuara,
5. Mbledhja e informatave nga menaxhmenti i shkollës dhe nga mësimdhënësit për dobinë e perceptuar të kësaj metodologjie,
6. Rishikimi i metodologjisë (sipas nevojës),
7. Shpërndarja e informatës për metodologjinë.

2.1. Shkollat pjesëmarrëse në projekt

Me gjithë faktin se është bërë përzgjedhja e shkollave, tri urbane dhe tri rurale, të cilat janë pajtuar për pjesëmarrje në projekt, një shkollë nuk ka qenë pjesë e këtij projekti, për shkaqe që janë jashtë ndikimit të projektit. Kështu, në projekt kanë marrë pjesë 5 shkolla fillore dhe të mesme të ulëta:

- “Abdullah Shabani” – Mitrovicë
- “Elena Gjika” – Tuneli i Parë (Mitrovicë)
- “Hilmi Rakovica” – Prishtinë
- “Agim Ramadani”, Zhegër (Gjilan)
- “Abaz Ajeti”, Gjilan

2.2. Metodologjia dhe procedurat e komunikimit me prindër

Janë organizuar dy punëtori për zhvillimin e metodologjisë dhe të procedurave të komunikimit me prindër me pjesëmarrje të deri në 5 përfaqësues të secilës shkollë pjesëmarrëse në projekt. Në mesin e pjesëmarrësve ka pasur administratorë, mësimdhënës dhe prindër, ndërsa diskutimet kanë qenë mjaft të gjalla. Në përfundim të procesit është zhvilluar dokumenti i dhënë në shtojcën 1.

2.3. Informimi rreth përdorimit të metodologjisë

Në të gjitha shkollat e përfshira janë organizuar sesione informimi për mësimdhënës rreth metodologjisë së komunikimit me prindër, që janë drejtuar nga ekspertë të KEC-it, është shpërndarë dokumenti i metodologjisë, si dhe janë diskutuar aspektet organizative të zbatimit të saj. Përqendrimi ka qenë në takimet individuale me prindër dhe në zhvillimin e tyre në mënyrë sa më efektive.

2.4. Monitorimi i shfrytëzimit të metodologjisë

Ekspertët e KEC-it kanë kaluar të paktën një ditë të plotë në secilën nga shkollat e përfshira me qëllim të monitorimit të zbatimit të metodologjisë. Gjatë këtyre vizitave janë zhvilluar biseda me mësimdhënës dhe me prindër, si dhe janë dhënë këshilla për realizimin më efektiv të takimeve individuale me prindër

2.5. Mbledhja e të dhënave

Për mbledhjen e të dhënave janë hartuar dy instrumente:

- Protokollin e intervistimit për drejtorë të shkollave (shtojca 2) të cilit i janë përgjigjur drejtorët e të pesë shkollave të përfshira,
- Pyetësori për mësimdhënës (shtojca 3), të cilin e kanë plotësuar 143 mësimdhënës nga të pesë shkollat e përfshira me përgjegjësi të veçantë për klasën – mësues klase ose kujdestarë klase.

3. Çështjet kryesore të sondazhit

Qëllimi kryesor i sondazhit të organizuar në pesë shkolla ishte të kuptohen efektet e zbatimit të metodologjisë së komunikimit me prindër në përmirësimin e komunikimit mësimdhënës-prind dhe shkollë-prind. Duhet pasur parasysh se metodologjia përqendrohet kryesisht në takime individuale të strukturuar, si dhe në faktin se gjatë realizimit të projektit është organizuar vetëm një raund i takimeve të tilla. Për këtë arsye, më shumë mund të bëhet fjalë për perceptimin e mësimdhënësve dhe drejtorëve të shkollave për dobinë e metodologjisë sesa për përfundime objektive në raport me ndikimin e saj në përmirësimin e komunikimit me prindër.

3.1. Përcaktimi i mostrës

Siç është shpjeguar më sipër, janë intervistuar drejtorët e pesë shkollave të përfshira në projekt, si dhe të gjithë mësuesit e klasës dhe të kujdestarëve të klasave në ato shkolla.

Tabela 1. Numri i të intervistuarve sipas shkollave

Shkolla	Drejtor	Mësimdhënës
“Hilmi Rakovica”-Prishtinë	1	33
“Abdullah Shabani”-Mitrovicë	1	31
“Abaz Ajeti”-Gjilan	1	31
“Elena Gjika”-Tuneli i Parë	1	19
“Agim Ramadani”-Zhegër	1	29

Gjithsej	5	143
-----------------	----------	------------

3.2. Realizimi i sondazhit

Intervistuesit kanë zhvilluar takime me secilin nga drejtorët e shkollave të përfshira, duke plotësuar bashkë pyetësozin, si dhe duke i kushtuar vëmendje të veçantë të gjitha vërejtjeve dhe sugjerimeve të tyre. Ndërkaq, pyetësozët u janë shpërndarë mësimdhënësve me kërkesë që t'i dorëzojnë te drejtori në afat prej 2 ditësh, në zarfe të mbyllura. Meqë nuk është kërkuar nga mësimdhënësit që të prezantohen, kemi arsye të besojmë se përgjigjet e tyre kanë qenë të sinqerta.

4. Rezultatet dhe analiza e tyre

4.1. Të dhëna demografike

Nga 143 mësimdhënësit e anketuar, 84 janë femra, ndërsa 59 meshkuj. Ndërkaq, 82 prej tyre janë mësues klase (1-5), ndërsa 58 kujdestarë të klasave (6-9). Tabelat 2 dhe 3 japin një pasqyrë të strukturës kualifikuese të personelit dhe të shpërndarjes sipas grupmoshave.

Tabela 2. Personeli i anketuar sipas kualifikimit

	Numri	Përqindja
Shkolla e lartë	80	55.9
Shkolla normale	17	11.9
Universiteti	44	30.8
Gjithsej	143	100.0

Tabela 3. Personeli i anketuar sipas grupmoshës

Mosha	Numri	Përqindja
<30	28	19.6
31-40	29	20.3
41-50	30	21.0
50+	55	38.5
Gjithsej	143	100.0

Ndërkaq, të pesë drejtorët e anketuar janë meshkuj, katër të moshës mbi 51 vjeç, dhe një i moshës 41-50 vjet. Me përjashtim të njërit, të gjithë drejtorët kanë arsimim universitar.

4.2. Variablat kyçe

Në mënyrë që rezultatet e anketës të jenë sa më frytdhënëse në kuptim të mundësisë për nxjerrjen e përfundimeve rreth çështjeve që kanë të bëjnë me komunikimin me prindër, pyetjet janë përmbledhur në dy tërësi:

- 1) Pikëpamja e të anketuarve lidhur me komunikimin me prindër,
- 2) Realizimi i komunikimi me prindër.

Derisa tërësia e parë ka të bëjë me këndvështrimet individuale ndaj komunikimit me prindër, e dyta ka për qëllim të mbledhë informata për rrjedhën e deritanishme të këtij komunikimi dhe zbatimin e metodologjisë për zhvillimin e takimeve individuale.

4.2.1. Pikëpamja lidhur me komunikimin me prindër

Pyetja e parë ka të bëjë me ndikimin e perceptuar që kanë prindërit në shkollë dhe në praktikën shkollore në disa sfera. Rezultatet janë prezantuar në tabelën 4.

Tabela 4. Perceptimi i ndikimit të prindërve në shkollë

Vlerësoni masën e ndikimit në përgjithësi që prindërit kanë në shkollën tuaj në jetën praktike shkollore në këto sfera:	Masë të madhe	Deri diku	Pak	Aspak
1.1. Vlerësimi i punës së mësimdhënësve.	73 (51.4%)	65 (45.8%)	0 (0.0%)	4 (2.8%)
1.2. Përzgjedhja e teksteve mësimore dhe e materialeve të tjera që përdoren në klasë.	48 (34.8%)	51 (37.0%)	12 (8.7%)	27 (19.6%)
1.3. Planifikimi i aktiviteteve sociale.	39 (28.5%)	48 (35.0%)	37 (27.0%)	13 (9.5%)
1.4. Zhvillimi i rregulloreve të shkollës.	76 (55.9%)	43 (31.6%)	10 (7.4%)	77 (5.1%)
1.5. Marrja e vendimeve në nivel të klasës.	95 (66.4%)	33 (23.1%)	13 (9.1%)	2 (1.4%)
1.6. Marrja e vendimeve në nivel të shkollës.	83 (59.7%)	37 (26.6%)	13 (9.4%)	6 (4.3%)

Perceptimi i drejtorëve është i ngjashëm me atë të mësimdhënësve, përveç në rastin e një shkolle ku drejtori konsideron se prindërit nuk kanë ndikim në vlerësimin e punës së mësimdhënësve, por,

pas verifikimit të dytë pohon se prindërit japin vlerësime për mësimdhënës, duke mos qenë në gjendje edhe të marrin vendime. Përndryshe, drejtorët përmendin shembuj të mirë të bashkëpunimit me prindër dhe të realizimit të ndikimit të tyre në jetën shkollore. Një drejtor përmend shembullin e zëvendësimit të një teksti mësimor me një tjetër pas reagimit të prindërve.

Tabela 5. Perceptimi i barrierave në komunikimin me prindër

Sa paraqesin barrierë dhe probleme në komunikimin me prindër të shkollës tuaj këto çështje:	Masë të madhe	Deri diku	Pak	Aspak
2.1. Mungesa e interesimit të prindërve të komunikojnë me shkollën.	47 (32.9%)	51 (35.7%)	17 (11.9%)	27 (18.9%)
2.2. Koha e kufizuar e prindërve që të informohen për çështjet e shkollës.	23 (16.7%)	58 (42.0%)	33 (23.9%)	24 (17.4%)
2.3. Mungesa e aftësive komunikuese të prindërve.	24 (17.3%)	46 (33.1%)	30 (21.6%)	39 (28.1%)
2.4. Mungesa e interesimit të mësimdhënësve të komunikojnë me prindër.	33 (24.4%)	15 (11.1%)	13 (9.6%)	74 (54.8%)
2.5. Ngarkesa me punë e mësimdhënësve.	42 (31.1%)	33 (24.4%)	15 (11.1%)	45 (33.3%)
2.6. Prindërit dhe mësimdhënësit nuk e flasin gjuhën e njëjtë.	18 (14.0%)	36 (27.9%)	27 (20.9%)	48 (37.2%)
2.7. Atmosfera e përgjithshme konfliktuoze në mes të shkollës dhe prindërve.	21 (15.4%)	25 (17.5%)	26 (19.1%)	64 (47.1%)
2.8. Mungesa e trajnimit të mësimdhënësve për punë me prindër	24 (17.5%)	32 (23.4%)	35 (25.5%)	46 (33.6%)

Tabela e mësipërme reflekton qëndrimet e mësimdhënësve në raport me barrierat e perceptuara të komunikimit me prindër. Shumë syresh e shohin mungesën e interesimit të prindërve si një ndër shkaktarët kryesorë të komunikimit jo të kënaqshëm me prindër, gjë që korrespondon plotësisht me qëndrimin e drejtorëve. Gjatë intervistës, drejtorët shprehën se mësimdhënësit më shumë parapëlqejnë të komunikojnë me prindërit e fëmijëve që kanë vështirësi në nxënie ose probleme me sjellje, të cilët, zakonisht, nuk janë shumë të interesuar për komunikim me prindër.

Tabela 6. Përfitimet e perceptuara të angazhimit të prindërve

Në përgjithësi cilat mendoni se janë përfitimet kryesore të angazhimit të prindërve:	Masë të madhe	Deri diku	Pak	Aspak
3.1. Përmirësimi i përgjithshëm i atmosferës në shkollë	91 (65.5%)	36 (25.9%)	10 (7.2%)	2 (1.4%)
3.2. Qëndrim dhe sjellje më pozitive e prindërve ndaj shkollës	88 (66.2%)	36 (27.1%)	7 (5.3%)	2 (1.5%)
3.3. Më shumë përkrahje në përgjithësi e prindërve për shkollën	84 (64.6%)	31 (23.8%)	12 (9.2%)	3 (2.3%)
3.4. Përmirësimi i performancës arsimore të nxënësve	86 (67.2%)	31 (24.2%)	10 (7.8%)	1 (0.8%)

Tabela 6 tregon se pjesa më e madhe e mësimdhënësve të anketuar janë plotësisht të ndërgjegjshëm për rëndësinë e angazhimit të prindërve në jetën e shkollës. Me këtë qëndrim pajtohen plotësisht edhe drejtorët e anketuar, të cilët, pa përjashtim, konsiderojnë se angazhimi i prindërve ndikon në masë të madhe në aktivitetet e shkollës.

4.2.2. Realizimi i komunikimit me prindër

Tabela vijuese jep informacion për dinamikën e komunikimit me prindër, e cila është e pranishme në shkollat e përfshira.

Tabela 7. Dinamika e komunikimit me prindër

Mesatarisht, sa shpesh ju, si mësimdhënës përgjegjës për klasën:	Së paku një herë në muaj	Së paku dy herë në gjysmëvjetor	Së paku një herë në gjysmëvjetor	Së paku një herë në vit
4.1. organizoni mbledhje të prindërve?	32 (23.5%)	101 (74.3%)	3 (2.2%)	
4.2. u dërgoni prindërve vlerësime me shkrim për suksesin e fëmijëve?	39 (29.1%)	37 (27.6%)	53 (39.6%)	5 (3.7%)
4.3. u dërgoni prindërve informata për plan-program?	10 (8.7%)	20 (17.4%)	39 (33.9%)	46 (40.0%)
4.4. u dërgoni prindërve informata lidhur me ngjarjet dhe aktivitetet në shkollë?	27 (21.6%)	40 (32.0%)	34 (27.2%)	24 (19.2%)
4.5. u dërgoni prindërve informata lidhur me politikat dhe rregullat e shkollës?	23 (19.8%)	27 (23.3%)	26 (22.4%)	40 (34.5%)
4.6. i ftoni prindërit për takim individual?	94 (71.2%)	30 (22.7%)	3 (2.3%)	5 (3.8%)
4.7. kryeni vizita nëpër shtëpi?	6 (6.8%)	22 (25.0%)	15 (17.0%)	45 (51.1)
4.8. kryeni sondazhe që të kuptohen opinionet/qëndrimet e prindërve?	6 (6.5%)	17 (18.5%)	17 (18.5%)	52 (56.5%)

Ndërkaq, tabela 8 jep informacion për realizimin e takimeve individuale me prindër në shkollat e përfshira në projekt. Vërehet se pjesa dërmuese e mësimdhënësve janë të bindur për dobinë e takimeve individuale, si dhe konsiderojnë se përdorimi i metodologjisë për takime individuale është treguar i dobishëm, si për mësimdhënës, ashtu edhe për prindër.

Tabela 8. Zbatimi i metodologjisë për takime individuale me prindër

Përcaktohuni për deklaratat e mëposhtme:	Pajtohem plotësisht	Pajtohem pjesërisht	Nuk pajtohem	Nuk pajtohem aspak
5.1. Mësimdhënësi dhe prindi patjetër duhet të gjejnë kohë për takim individual	126 (94.0%)	6 (4.5%)	1 (0.7%)	1 (0.7%)
5.2. Mësimdhënësi duhet të jetë i përgatitur për takim individual	125 (94.0%)	8 (6.0%)		
5.3. Prindi duhet të jetë i përgatitur për takim individual	103 (78.0%)	23 (17.4%)	4 (3.0%)	2 (1.5%)
5.4. Takimet individuale janë në dobi të fëmijëve	137 (97.8%)	2 (1.5%)	1 (0.7%)	
5.5. Metodologjia e hartuar për takim individual ka qenë e dobishme për mua	113 (84.3%)	19 (14.2%)	1 (0.7%)	1 (0.7%)
5.6. Metodologjia e hartuar për takim individual ka qenë e dobishme për prindin	120 (89.6%)	12 (9.0%)	1 (0.7%)	1 (0.7%)

Edhe drejtorët e shkollave kanë konfirmuar se takimet individuale të zhvilluara kanë ndikuar pozitivisht, si te mësimdhënësit, ashtu edhe te prindërit.

5. Përfundimi

Mësimdhënësit e anketuar dhe drejtorët e shkollave të përfshira në këtë projekt janë të bindur se prindërit kanë ndikim në jetën e shkollës, si dhe se përfshirja e tyre në jetën e shkollës ka implikime pozitive për punën e saj dhe për vetë fëmijët. Ata janë të ndërgjegjshëm për barrierat që e pengojnë komunikimin efektiv shkollë-prindër, e ku vend të rëndësishëm zë mungesa e interesimit të prindërve për komunikim me shkollën. Një shkaktar i kësaj mungese interesimi mund të jetë pikërisht mënyra se si shkolla e organizon komunikimin me prindër, që, sipas vetë përgjigjeve të të anketuarve, kryesisht reduktohet në organizimin e mbledhjeve të kohëpaskohshme me prindër.

Komunikimi individual me prindër nuk është formë e panjohur për shkollat e Kosovës, por është fakt që, kjo formë komunikimi nuk zbatohet në mënyrë të rregullt dhe obliguese nëpër shkolla. Përkundrazi, takimet individuale me prindër rëndom iniciohen nga shkolla ose nga mësimdhënësi, në ato raste kur paraqiten probleme me nxënien ose me sjelljen e nxënësit në shkollë.

Metodologjia e zhvilluar në kuadër të këtij projekti përcakton një strukturë të zhvillimit të këtyre takimeve, e cila mund të zbërthehet në 4 hapa: 1) Mësimdhënësi fton prindin për takim individual; 2) Mësimdhënësi dhe prindi përgatiten për takim individual; 3) Zhvillohet takimi individual; 4) Merren masa për avancimin e pozitës së nxënësit në shkollë. Zbatimi i metodologjisë, pa dyshim, kërkon përkushtim të madh nga ana e shkollës dhe e mësimdhënësve të saj. Shkolla është ajo që duhet të përcaktojë orarin e takimeve individuale dhe t'i përgatisë mësimdhënësit për këto takime, ndërkaq këta të fundit e bartin barrën kryesore të organizimit të tyre. Ndërkaq, pas përfundimit të takimeve shkolla duhet të bëjë një analizë të takimeve individuale, duke bërë përpjekje që të nxjerrë përfundime për të ardhmen.

Hulumtimi i zhvilluar në pesë shkollat e përfshira në projekt tregoi se ideja e takimeve individuale të strukturuar vlerësohet nga mësimdhënësit dhe nga drejtorët e shkollave. Metodologjia e propozuar është pritur mirë nga mësimdhënësit dhe nga prindërit, por kjo nuk d.m.th. se shkollat nuk mund t'ia përshtatin atë nevojave dhe kërkesave të veta.

KOMUNIKIMI ME PRINDËR

HYRJE

Nga studimet e deritashme është vërtetuar se pjesëmarrja e prindërve në shkollë kontribuon në cilësinë dhe në efikasitetin e saj, sepse prindërit/kujdestarët e fëmijëve janë të rriturit më me ndikim në jetën e nxënësve. Në shkollën e mesme të ulët, ky ndikim është edhe më i madh në të nxëniet e nxënësve me përfshirjen e prindërve në jetën e shkollës.

Bashkëpunimi i pamjaftueshëm, deri tani, ndërmjet shkollës dhe prindërve ka bërë shpesh që në shkollë të mungojnë rezultatet, të pësojnë shumë fëmijë, që metodat dhe stilet e punës së mësimdhënësve të mos jenë sa duhet efikase dhe të suksesshme. Në ngritjen e cilësisë dhe të efikasitetit pa dyshim që do të ketë ndikim krijimi i partneritetit të barabartë me prindër nga i tërë personeli i shkollës duke filluar nga drejtori dhe mësimdhënësit.

Dihet mirëfilli që roli primar i mësimdhënësit është të punojë me nxënës për arsye të ndryshme dhe në forma të ndryshme, por roli më me rëndësi dhe më shpërblyes i tij përfshin punën me prindër, nga fakti se qëndrimet e nxënësve për shkollën ndikohen jo pak nga prindërit e tyre, gjegjësisht nga familja.

Nëse prindërit ndihen mirë dhe të kënaqur me mësimdhënësit dhe me shkollën e fëmijëve, atëherë shumë më lehtë dhe më me dëshirë fëmijët do ta pranojnë inkurajimin për sjellje pozitive në shkollë. Një element i rëndësishëm është edhe ai që prindërit duhet të informohen mirë dhe me rregull për sjelljet dhe të arriturat e fëmijëve të tyre, ngase vetëm ashtu mund të ndikojmë në përmirësimin e tyre, kur është nevoja.

Prindërit, po ashtu mund të jenë burim i vlefshëm për mësimdhënie efektive duke u ndihmuar vullnetarisht fëmijëve, duke u asistuar mësimdhënësve në përgatitjen e materialeve për mësimdhënie ose duke shkëmbyer përvojën e tyre profesionale me nxënës përmes ligjëratave, prezantimeve e vizitave të ndryshme me rëndësi. Për krijimin e kontakteve pozitive me ta, prindërit, gjithashtu vlen të përfshihen në hartimin e plan-programeve, në procedurat kryesore të shkollës në fillim të vitit shkollor, etj.

Ngaqë prindërit nuk janë aspak më ndryshe nga nxënësit dhe mësimdhënësit ka të ngjarë që të ndihen më mirë dhe t'i mbrojnë çështjet të cilat i kanë të qarta dhe për të cilat u është dhënë rasti të diskutojnë më herët, dhe nëse ata perceptojnë që mirëprehen me ngrohtësi e me respekt dhe duke i familjarizuar me rregullat e shkollës, shumë më tepër janë në gjendje të ndihmojnë në të arriturat e nxënësve dhe të na ndihmojnë nëse vjen deri te problemi eventual.

Duke u nisur nga fakti që interesimi i mësimdhënësve për komunikim me prindër (përveç mbledhjeve me prindër) e ka fokusin në sjelljet jo të mira të nxënësve, gjë e cila i bën të mos ndihen mirë si shkak i komunikimit të rrallë duhet bërë përpjekje në iniciimin e takimeve relativisht të shpeshta me ta, për arsye se përparimi i fëmijës është shumë me rëndësi për prindin. Nuk duhet hezituar që të përfitohen

prindërit duke u folur çështjet se sa inteligjent dhe i shkathët është fëmija i tyre dhe se sa mirë kalon me të tjerët, në të kundërtën duhet përballur me prindër që përlëshen në shkollë, sepse informatat për fëmijën e tyre, që u përcillen janë gjithnjë negative.

Është e qartë se komunikimi prindër – shkollë do të na shpenzojë kohë dhe energji, por sikur të gjitha çështjet në profesionin tonë, kërkon praktikë para se t'u përshtatemi atyre dhe të ndihemi rehatshëm gjatë takimeve me ta.

Ky do të jetë shpërblim gjatë praktikës sonë të mësimdhënies, sepse në punën tonë do të vërehet dukshëm përmirësimi në cilësinë e sjelljes dhe të nxënies e nxënësve, i cili edhe është synimi përse e kemi zgjedhur këtë profesion.

MBLEDHJET ME PRINDËR

Konsiderohen si forma më e zakonshme, ndonjëherë edhe e vetmja e komunikimit me prindër në praktikën kosovare. Kjo ka bërë që partneriteti prindër-shkollë të ketë më tepër karakter formal duke u konsumuar në këto mbledhje përmes informimit të prindërve për rezultatet e fëmijëve të tyre.

Jo rrallë prindërit nuk janë bërë të ndihen mirë nga mënyra e tillë e informimit për të arriturat dhe sjelljet e fëmijës së tyre, dhe kjo ka ndikuar me krijimin e një barriere, me ndërprerje kontaktesh të tyre me shkollën, madje edhe atëherë kur është e domosdoshme.

Mbledhjet me prindër organizohen 4 herë gjatë vitit shkollor dhe janë të përcaktuara nga organet udhëheqëse të shkollës bashkë me agjendën. Ato mbahen në nivel të paraleleve të shkollës dhe në kohën e njëjtë, sipas klasave.

Në fillim të vitit, mbledhjet kanë karakter informativ dhe udhëhiqen nga mësuesit/ kujdestarët e klasave, ku prindërit njoftohen me politikat e rregullat e shkollës, me investimet kapitale dhe aktivitetet e planifikuara, me planet dhe programet e shkollës e tekstet mësimore.

Po ashtu, në këto mbledhje zgjidhen me votën e prindërve përfaqësues nga radha e prindërve për këshillin e prindërve të shkollës.

Gjatë gjysmëvjetorit, mbledhja me prindër u kushtohet informimit për të arriturat dhe sjelljen e nxënësit si dhe çështjeve që kanë të bëjnë me problemet eventuale në shkollë. Prindërve u shpërndalet pasqyra e suksesit dhe e vijimit në mësim (Shtojca 2) . Në raste të veçanta, çështjet diskutohen me prindin ndaras, pas takimit të përbashkët.

Kjo ka bërë që gradualisht të mendohet se mbledhjet tradicionale me prindër ka nevojë të zëvendësohen me **takime individuale** me ta ku komunikimi në mes palëve do të jetë më i hapur dhe me rezultate të pritshme (poshtëshënuar procedura).

Çështje që i ndihmojnë partneritetit të suksesshëm të shkollës me prindër

* Do të ishte me shumë interes që para kontakteve të para me prindër t'u dërgohet një letër hyrëse, të kemi një takim fillestar, t'ua dërgojmë orarin mësimor, planin mësimor, planin e aktiviteteve, kalendarin e vitit shkollor dhe orarin e mbledhjeve me prindër.

* Varësisht nga kushtet që disponojmë janë të rëndësishme edhe dërgimi i raporteve të progresit të fëmijës, telefonatat, komunikimi me e-mail, letra informative e shkollës, vizitat familjare, pjesëmarrja e prindërve në aktivitete mësimore e jashtëmësimore, bashkëpunimi me prindër të minoriteteve të shkollës (nëse ka), etj.

TAKIMET INDIVIDUALE ME PRINDËR

Pas mbledhjeve të përbashkëta në fillim të vitit shkollor si dhe takimit iniciues për njoftim me prindërit/ kujdestarët e fëmijëve me të cilët punojmë, takimet individuale janë një nga format e parapëlqyera për prindërit e nxënësve.

Në shkollat tona, në të kaluarën, praktikoheshin që të gjitha problemet me nxënës qofshin individuale apo kolektive të diskutoheshin në praninë e të gjithë prindërve duke kaluar përciptazi nëpër probleme apo dhe si rezultat duke mos e zgjuar vëmendjen e të gjithëve për zgjidhjen e tyre, e cila do të ndikonte në ngritjen e cilësisë së mësimnxënies. Në ato raste, jo rrallë, disa nga prindërit largoheshin nga mbledhja me arsyetimin që kanë ndonjë obligim tjetër, disa të tjerë diskutonin në mes vete për çështje të tjera apo krijoreshin debate të panevojshme të cilat nuk i shërbenin askujt dhe përfundonin pa ndonjë epilog pozitiv.

Kjo i bënte prindërit e nxënësve “të etiketuar” të mos ndiheshin mirë, të skuqeshin nga “bëmat” e fëmijës së tyre dhe si shkak i pakënaqësisë së krijuar të mos ndërmerinin asnjë hap pozitiv për t’i ndihmuar fëmijës dhe shkollës në zgjidhjen e problemit.

Kishte raste kur mbledhjet kishin për temë bisedën vetëm për nxënësit e dalluar duke përmendur emra, ashtu që krijohej një ndjenjë e mosbesimit të mjaftueshëm të prindërve tjerë për përparimin e fëmijës së tyre (i cili nuk përmendej) dhe dyshimi nëse biri/ bija e tyre kishte vlera apo mund të radhitej në mesin e më të mirëve.

Në literaturë dhe në praktikën e shkollave efektive, shihet që komunikimi i drejtë dhe i hapur në bisedë individuale me prindër ka dhënë rezultate shumë më të pritshme për suksesin e gjithëmbarshtëm të shkollës.

Nëse i bëjmë ftesë prindit të takohemi individualisht me të për të shqyrtuar shkallën e të arriturave dhe sjelljen e fëmijës së tij, ai do ta kuptojë se jemi të interesuar për përparimin e nxënësit dhe kemi vullnet për të ndryshuar gjithnjë në të mirë gjendjen aktuale të fëmijës. Kjo ndikon në shtimin e përgjegjësisë të të gjitha palët me interes si nxënësi – prindi- shkolla.

Nëse jemi të përgatitur mirë, atëherë takimi do të jetë mjaft i lehtë dhe i këndshëm e që të arrihet kjo duhet pasur parasysh disa komponentë që i ndihmojnë mbarësisë së takimit si:

- Të përhëndetemi në mënyrë të ngrohtë dhe miqësore me prindin/ kujdestarin e fëmijës.
- Të fillojmë me sjelljet pozitive të fëmijës në shkollë dhe duke inkurajuar atë të flasë edhe vetë për sjelljet e mira që i ka vërejtur te fëmija kohët e fundit dhe nga të cilat ka mbetur i kënaqur.
- I japim të lexojë raportin/ pasqyrën e suksesit, në mënyrë që më pas të përballemi me më pak pyetje dhe kritika (do të kuptohet shumëçka gjatë leximit).
- Gjithmonë të flasim për gjërat pozitive po aq sa për ato negative (të fillojmë sa më butë të flasim për gjërat e pakëndshme si: “Do ta inkurajoja nxënësin të...”).
- Në përmbledhje i dëgjoni nëse kanë pyetje e nëse jo i inkurajoni t’i bëjnë ato në mënyrë që të qartësohen mendimet. Shkurtimisht i përmbledhim gjërat pozitive, negative duke këshilluar për përmirësimin e tyre. Parapëlqehet t’i kemi në formë të shkruar gjërat me rëndësi, në mënyrë që të mbahen mend.

Përgatitjet për takim

- Çdo kujdestar klase ka për obligim ta mbajë një takim të tillë brenda gjysmëvjetorit
 - Nxënësit e ciklit të mesëm të ulët duhet të përgatiten për këto takime

- Vetëvlerësimi (Shtojca 1)
 - Ftesa për takim bëhet të paktën një javë më herët
- Përgatitni të dhënat e nevojshme
 - Përgatitet pasqyra e suksesit dhe e vijimit për çdo nxënës. (Shtojca 2)
 - Dosja e nxënësit (nëse mbahet) duhet të jetë e kompletuar, si në pjesën e notave, ashtu edhe në pjesën e testeve, punimeve dhe raporteve të ndryshme.
 - Mblidhni informata nga arsimtarët tjerë dhe konsultoni shënimet e Juaja për nxënësin.
- Nëse e konsideroni të nevojshme siguroni pjesëmarrjen në takim të pedagogut, psikologut, drejtorit, zëvendësdrejtorit, ose të arsimtarëve të tjerë.
- Në varësi nga kushtet infrastrukturore, takimet individuale mund të organizohen edhe në intervalin kohor në mes të ndërrimeve, ose pas përfundimit të mësimit.

Agjenda e takimit

(Shtojca 3)

- Diskutimi për vetëvlerësimin e nxënësit
- Diskutimi i raportit të suksesit dhe vijimit në mësim
- Diskutimi për dosjen e nxënësit dhe shikimi i punimeve (teste, etj.)
- Sjelljet e nxënësit dhe raportet me shokë
- Pyetjet dhe brengat e prindit
- Përmbledhja e takimit
 - Po qe nevoja, në marrëveshje me prindin hartohet edhe plani për përmirësim (Shtojca 4)
- Kopja mbetet në shkollë

Pas takimit

- Raportimi

Shtojca 1

VETËVLERËSIM

Emri dhe mbiemri i nxënësit _____

Gjuhë dhe letërsi shqipe

1. Sa libra ke lexuar gjatë këtij gjysmëvjetori? _____
2. Mendon që i ke përvetësuar në masë rregullat gjuhësore? _____
3. I bën me rregull detyrat? _____
4. Çfarë do të interesonte më shumë në këtë lëndë?

Matematikë

1. Je aktiv në orën e mësimit? _____
2. I bën me rregull detyrat? _____
3. Ke ushtruar edhe detyra që nuk të janë dhënë nga arsimtari? _____
4. Ke nevojë më tepër për ndihmë në këtë lëndë (nga arsimtari apo dikush tjetër)?

Gjuhë angleze

1. Je i kënaqur me njohjen tënde të gjuhës angleze? _____
2. I bën me rregull detyrat? _____
3. Shikon filma, dëgjon këngë ose lexon libra në anglishte? _____

Në cilat lëndë të shkon puna mirë? _____

Ku të duhet më shumë punë/ ndihmë? _____

Sa ke përparuar në shprehitë e Tua gjatë këtij gjysmëvjetori?

Vendos njëren nga shenjat e mëposhtme në vendin përkatës:

- + kam përparuar shumë
- = jam i kënaqur me përparimin tim
- nuk jam i kënaqur

Shprehitë e të nxënës

- _____ Dëgjoj udhëzimet
- _____ Detyrat i kryej me kohë
- _____ Punoj mirë në grup
- _____ Jam pedant në punë dhe e mbaj në rregull tavolinën
- _____ E pranoj përgjegjësinë për punën time

Fushat personale

_____ I kam parasysh ndjenjat e të tjerëve

- _____ I respektoj rregullat e shkollës
- _____ Kujdesem për gjërat e mia
- _____ Kontrolltoj sjelljen time dhe pranoj përgjegjësinë për të (sillem mirë)
- _____ Kaloj mirë me shokët

Nëse do të thuash diçka tjetër lidhur me mësimdhënien/ mësimdhënësit, të lutem përdore hapësirën në vijim:

Faleminderit për bashkëpunim!

Shtojca 2

PASQYRA E SUKSESIT DHE E VIJIMIT NË MËSIM

Klasa VI-1		
EMRI DHE MBIEMRI		1.11.2009
Nr.	Lënda	Nota
1.	Gjuhë shqipe	
2.	Gjuhë angleze	
3.	Histori	
4.	Edukatë qytetare	
5.	Gjeografi	
6.	Fizikë	
7.	Matematikë	
8.	Biologji	
9.	Kimi	
10.	Edukatë figurative	
11.	Edukatë muzikore	
12.	TIK	
13.	Edukatë fizike	
14.	Lëndë zgjedhore	
Mungesa të arsyeshme		Mungesa të pa arsyeshme

PYETJE ORIENTUESE PËR PRINDIN

Emri dhe mbiemri i nxënësit _____

1. Cili është qëndrimi i përgjithshëm i fëmijës Tuaj ndaj shkollës këtë vit (A i pëlqen? A po përparon sa duhet? A vjen me dëshirë në shkollë)?
2. Për çfarë interesohet fëmija Juaj më së shumti në shkollë?
3. Cilat janë brengat më të mëdha të fëmijës Tuaj në shkollë?
4. Në cilën fushë dëshironi të shihni se fëmija Juaj punon/ përparon shumë?
5. Cilat janë disa cilësi pozitive të fëmijës Tuaj që t'i kemi parasysh (p.sh. saktësia, durimi, solidariteti, etj.)?
6. Ku gjykoni se ka vështirësi fëmija Juaj? Cila lëndë i duket më e vështirë?
7. Cilat lëndë/aktivitete mendoni se i pëlqejnë fëmijës Tuaj?
8. A mendoni që më tepër i pëlqen të punojë në grup apo vetëm?
9. Me se merret gjatë kohës së lirë në shtëpi, fëmija Juaj (lexon, hulumton tema mësimore në internet, luan sport, shikon TV, etj.)?
10. Çfarë i pëlqen më shumë dhe çfarë do të kishte ndryshuar fëmija Juaj në këtë shkollë?
11. Sugjerime ose komente të tjera që na ndihmojnë të punojmë më mirë me fëmijën Tuaj?

Ju faleminderit!

Shtojca 4

PLANI PËR PËRMIRËSIM

Emri i nxënësit: _____

Emri i kujdestarit: _____

Emri i prindit: _____

Data: _____

Në cilat fusha nevojitet përmirësimi: _____

Çfarë do të bëjë nxënësi? _____

Çfarë do të bëjë arsimtari? _____

Çfarë do të bëjë prindi? _____

Shtojca 2: Protokoll i intervistimit për drejtorë

PYETËSOR PËR DREJTORIN

Për fillim na nevojiten ca të dhëna për Ju:

Shkolla: _____

Kualifikimi shkollor: Shkolla normale Shkolla e lartë Universiteti

Grupmosha: <30 vjeç 31-40 41-50 51+

Gjinia: 1. Mashkull 2. Femër

Moduli 1 – Pikëpamja Juaj lidhur me komunikimin me prindër

1. Vlerësoni masën e ndikimit në përgjithësi që prindërit kanë në shkollën tuaj në jetën praktike shkollore në këto sfera:

	Masë të madhe	Deri diku	Pak	Aspak	Nuk e di
1.1. Vlerësimi i punës së mësimdhënësve.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
1.2. Përzgjedhja e teksteve mësimore dhe e materialeve të tjera që përdoren në klasë.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
1.3. Planifikimi i aktiviteteve sociale.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
1.4. Zhvillimi i rregulloreve të shkollës.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
1.5. Marrja e vendimeve në nivel të klasës.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
1.6. Marrja e vendimeve në nivel të shkollës.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

KOMENTE:

2. Sa paraqesin barrierë dhe probleme në komunikimin me prindër të shkollës tuaj këto çështje:

	Masë të madhe	Deri diku	Pak	Aspak	Nuk e di
2.1. Mungesa e interesimit të prindërve të komunikojnë me shkollë.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
2.2. Koha e kufizuar e prindërve që të informohen për çështjet e shkollës.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
2.3. Mungesa e aftësive komunikuese të prindërve.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
2.4. Mungesa e interesimit të mësimdhënësve të komunikojnë me prindër.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
2.5. Ngarkesa me punë e mësimdhënësve.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
2.6. Prindërit dhe mësimdhënësit nuk e flasin gjuhën e njëjtë.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
2.7. Atmosfera e përgjithshme konfliktuoze në mes të shkollës dhe prindërve.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
2.8. Mungesa e trajnimit të mësimdhënësve për punë me prindër	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

KOMENTE:

3. Në përgjithësi cilat mendoni se janë përfitimet kryesore të angazhimit të prindërve:

	Masë të madhe	Deri diku	Pak	Aspak	Nuk e di
3.1. Përmirësimi i përgjithshëm i atmosferës në shkollë	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
3.2. Qëndrim dhe sjellje më pozitive e prindërve ndaj shkollës	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
3.3. Më shumë përkrahje në përgjithësi e prindërve për shkollën	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
3.4. Përmirësimi i performancës arsimore të nxënësve	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

KOMENTE:

Moduli 2 – Realizimi i komunikimit me prindër

4. Mesatarisht, sa shpesh në shkollën tuaj:

	Së paku një herë në muaj	Së paku dy herë në gjysmëvjetor	Së paku një herë në gjysmëvjetor	Së paku një herë në vit	Nuk e di
4.1. organizohen mbledhjet e prindërve?	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
4.2. u dërgohen prindërve vlerësime me shkrim për suksesin e fëmijëve?	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
4.3. u dërgohen prindërve informata për plan-program?	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
4.4. u dërgohen prindërve informata lidhur me ngjarjet dhe aktivitetet në shkollë?	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
4.5. u dërgohen prindërve informata lidhur me politikat dhe rregullat e shkollës?	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
4.6. ftohen prindërit për takim individual?	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
4.7. mësimmshënësit apo personeli profesional përkrahës kryejnë vizita nëpër shtëpi?	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
4.8. kryhen sondazhe që të kuptohen opinionet/qëndrimet e prindërve?	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

KOMENTE:

5. Tani, na jepni ca informata për takime individuale me prindër!A është zbatuar te ju Metodologjia e komunikimit me prindër për organizimin e takimeve individuale? Po Jo

Nëse PO përcaktohuni për deklaratat e mëposhtme

	Pajtohem plotësisht	Pajtohem pjesërisht	Nuk pajtohem	Nuk pajtohem aspak	Nuk e di
5.1. Mësimdhënësi dhe prindi patjetër duhet të gjejnë kohë për takim individual	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
5.2. Mësimdhënësi duhet të jetë i përgatitur për takim individual	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
5.3. Prindi duhet të jetë i përgatitur për takim individual	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
5.4. Takimet individuale janë në dobi të fëmijëve	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
5.5. Metodologjia e hartuar për takim individual ka qenë e dobishme për mësimdhënësit	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
5.5. Metodologjia e hartuar për takim individual ka qenë e dobishme për prindin	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

KOMENTE:

Shtojca 3: Pyetësi për mësimdhënësit

PYETËSOR PËR MËSIMDHËNËS

Luteni që këtë pyetësor ta plotësoni dhe ta dorëzoni në zarf të mbyllur te drejtori i shkollës.

Për fillim na nevojiten ca të dhëna për Ju:

Shkolla: _____

Kualifikimi shkollor: Shkolla normale Shkolla e lartë Universiteti

Grupmosha: <30 vjeç 31-40 41-50 51+

Klasat ku mbani mësim: 1-5 6 7 8 9

Gjinia: 1. Mashkull 2. Femër

Moduli 1 – Pikëpamja Juaj lidhur me komunikimin me prindër

1. Vlerësoni masën e ndikimit në përgjithësi që prindërit kanë në shkollën tuaj në jetën praktike shkollore në këto sfera:

	Masë të madhe	Deri diku	Pak	Aspak	Nuk e di
1.1. Vlerësimi i punës së mësimdhënësve.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
1.2. Përzgjedhja e teksteve mësimore dhe e materialeve të tjera që përdoren në klasë.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
1.3. Planifikimi i aktiviteteve sociale.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
1.4. Zhvillimi i rregulloreve të shkollës.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
1.5. Marrja e vendimeve në nivel të klasës.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
1.6. Marrja e vendimeve në nivel të shkollës.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

2. Sa paraqesin barrierë dhe probleme në komunikimin me prindër të shkollës tuaj këto çështje:

	Masë të madhe	Deri diku	Pak	Aspak	Nuk e di
2.1. Mungesa e interesimit të prindërve të komunikojnë me shkollën.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
2.2. Koha e kufizuar e prindërve që të informohen për çështjet e shkollës.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
2.3. Mungesa e aftësive komunikuese të prindërve.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
2.4. Mungesa e interesimit të mësimdhënësve të komunikojnë me prindër.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
2.5. Ngarkesa me punë e mësimdhënësve.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
2.6. Prindërit dhe mësimdhënësit nuk e flasin gjuhën e njëjtë.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
2.7. Atmosfera e përgjithshme konfliktuoze në	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

mes të shkollës dhe prindërve.					
2.8. Mungesa e trajnimit të mësimitdhënësve për punë me prindër	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

3. Në përgjithësi cilat mendoni se janë përfitimet kryesore të angazhimit të prindërve:

	Masë të madhe	Deri diku	Pak	Aspak	Nuk e di
3.1. Përmirësimi i përgjithshëm i atmosferës në shkollë	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
3.2. Qëndrim dhe sjellje më pozitive e prindërve ndaj shkollës	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
3.3. Më shumë përkrahje në përgjithësi e prindërve për shkollën	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
3.4. Përmirësimi i performancës arsimore të nxënësve	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

Moduli 2 – Realizimi i komunikimit me prindër

4. Mesatarisht, sa shpesh ju, si mësimitdhënës përgjegjës për klasën:

	Së paku një herë në muaj	Së paku dy herë në gjysmëvjetor	Së paku një herë në gjysmëvjetor	Së paku një herë në vit	Nuk e di
4.1. organizoni mbledhje të prindërve?	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
4.2. u dërgoni prindërve vlerësime me shkrim për suksesin e fëmijëve?	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
4.3. u dërgoni prindërve informata për plan-program?	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
4.4. u dërgoni prindërve informata lidhur me ngjarjet dhe aktivitetet në shkollë?	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
4.5. u dërgoni prindërve informata lidhur me politikat dhe rregullat e shkollës?	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
4.6. ftoni prindërit për takim individual?	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
4.7. kryeni vizita nëpër shtëpi?	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
4.8. kryeni sondazhe që të kuptohen opinionet/qëndrimet e prindërve?	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

5. Tani, na jepni ca informata për takime individuale me prindër!

A e keni zbatuar Metodologjinë e komunikimit me prindër për organizimin e takimeve individuale? Po Jo

Nëse PO përcaktoheni për deklaratat e mëposhtme

	Pajtohem plotësisht	Pajtohem pjesërisht	Nuk pajtohem	Nuk pajtohem aspak	Nuk e di
5.1. Mësimitdhënësi dhe prindi patjetër duhet të gjejnë kohë për takim individual	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
5.2. Mësimitdhënësi duhet të jetë i përgatitur për takim individual	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
5.3. Prindi duhet të jetë i përgatitur për takim individual	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
5.4. Takimet individuale janë në dobi të fëmijëve	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
5.5. Metodologjia e hartuar për takim individual ka qenë e dobishme për mua	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
5.5. Metodologjia e hartuar për takim individual	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

ka qenë e dobishme për prindin					
--------------------------------	--	--	--	--	--